



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

**Zl.Anr.53/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugë publike për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 25.09.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 800.00 (tetëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 23.09.2017, nga LVV, me të cilën pretendon se me datë 22 shtator, aktivistët e tyre kanë vërejtur se në Rrugën “Driton Islami” në Ferizaj, mbi rrugë publike është vendosur baneri i kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal, nga radhët e LDK-së. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e rregullave zgjedhore në momentin e vendosjes së banerit në hapsirë publike.

Në përgjigjen në ankesë, të datës 24.09.2017, LDK thekson se kjo shkelje ka mundur të ndodhë pa dashje nga disa nga kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal, në mungesë të njohurive me dispozitat ligjore përkatëse dhe rregullat e KQZ-së, sido që të jetë pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së ka ndërmarrë masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur dy fotografi nga vendi ku është larguar baneri.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

## Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal nga radhët e subjektit politik LDK është vendosur mbi rrugë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që baneri i kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal nga radhët e subjektit politik LDK është vendosur mbi rrugë publike. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë subjekti politik, në përgjigjen në ankesë të datës 24.09.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se e njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që e kanë tërhequr banerin nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

Zl.Anr. 53/2017 më datën 25.09.2017



**Kryesuesi i Panelit**  
Gyltene Sylejmani

*Gyltene Sylejmani*

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.